

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit G.D, nga ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 3135/2012 të datës 07.12.2012, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të prokurorisë Themelore në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit, të dëmtuarit E.K, me date 24.09.2014 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.D, nga i ati R.. dhe nëna D.. e lindur ... i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton, rruga "...", nr....., ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 22.06.2012, rreth orës 13,00 minuta, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, rrezikon trafikun publik dhe jetën e njerëzve, vepron me pakujdesi dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 dhe 126 të LSKRR, në atë mënyrë që duke drejtuar motoçikletën e markës "Mondial", me tabela të regjistrimit ..., me ngjyrë të kaltërt, pa leje, në rrugën lokale ..., saktësisht përball ndërtesës së zjarrfikësve në ..., shpejtësinë e lëvizjes nuk ia përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë, gjegjësisht drejton motoçikletën me shpejtësinë më të madhe se shpejtësia e lejuar për atë pjesë të rrugës, si dhe nuk mbanë distancën e nevojshme (distancën e sigurisë) ndaj mjetit i cili ka qenë në lëvizje para tij, në momentin kritik godet si pasojë e kësaj në pjesën e pasme automjetin "BMW" të cilin ka qenë duke e drejtuar K.Gj, nga ..., me tabela të regjistrimit ..., ku përveç dëmeve të shkaktuara materiale në të dy automejtet, lëndime trupore pëson vet i pandehuri si dhe bashkudhëtari në motoçikletën e tij, i dëmtuari E.K, lëndime për këtë të fundit me karakter të rëndë trupor, të përshkruara më afër në mendimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. Sh.Z, të datës 20.10.2012.

Këso dore ka kryer veprën penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragraf 3 të KPK-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KP-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërtetohet dënimi me burg ne kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,44 euro, dhe në emër të ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit shumë prej 40,88 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumën prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari E.K, nga ..., rruga "...", nr..., për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 3135/2012 të datës 07.12.2012, kundër të akuzuarit G.D, nga ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 te KPK-ës,

Prokurori i shtetit Elfete Purova në fjalën e saj përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3135/2012 të datës 07.12.2012, të parashtruar ndaj të pandehurit G.D, për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 të KPK-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm fillestar në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I dëmtuari E.K, në fjalën e tij përfundimtare deklaron, si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pronësoresh juridike, për lartësinë e të cilës do të deklarohet në kontestin e rregullt civilë.

I akuzuari G.D, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, më vije keq për rastin e ndodhur, unë i kërkoj falje këtu të dëmtuarit E.K, e tëra ka ndodhur pa dëshirën dhe vullnetin tim, dhe nuk ka ekzistuar qëllimi për kryerjen e veprës, kjo është hera e parë që bie në konflikt me ligjin, dhe i premtoj gjykatën që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprat të tilla apo të ngjashme. Unë me të dëmtuarin Edmond i kam raportet e mira, dhe sot e kësaj dite shoqërohem. I premtoj gjykatës, që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm në veprimet e mia.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 22.06.2012, rreth orës 13,00 minuta, i akuzuari, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, rrezikon trafikun publik dhe jetën e njerëzve, vepron me pakujdesi dhe

në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 dhe 126 të LSKRR, në atë mënyrë që duke drejtuar motoçikletën e markës “Mondial”, me tabela të regjistrimit ..., me ngjyrë të kaltërt, pa leje, në rrugën lokale ..., saktësisht përball ndërtesës së zjarrfikësve në ..., shpejtësinë e lëvizjes nuk ia përshat kushteve dhe rrethanave në rrugë, gjegjësisht drejton motoçikletën me shpejtësinë më të madhe se shpejtësia e lejuar për atë pjesë të rrugës, si dhe nuk mbanë distancën e nevojshme (distancën e sigurisë) ndaj mjetit i cili ka qenë në lëvizje para tij, në momentin kritik godet si pasojë e kësaj në pjesën e pasme automjetin “BMW” të cilin ka qenë duke e drejtuar K.Gj, nga Prizreni, me tabela të regjistrimit ..., ku përveç dëmeve të shkaktuara materiale në të dy automejtet, lëndime trupore pëson vet i pandehuri si dhe bashkudhëtari në motoçikletën e tij, i dëmtuari E.K, lëndime për këtë të fundit me karakter të rëndë trupor, të përshkruara më afër në mendimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. Sh.Z, të datës 20.10.2012.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPPK-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragraf 3 të KPK-ës.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese gjykata ka marrë faktin që përpos dëmeve materiale të shkaktuara lëndime të rënda trupore ka pësuar i dëmtuari E.K, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, pendimi i thellë i të akuzuarit, kërkim falja para gjykatës ndaj të dëmtuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, mosha e të akuzuarit si dhe gjendja e tij ekonomike, gjerë më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, komform nenit 74 të KP gjykata mori parasysht rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm e të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajit, keqardhjen e shfaqur, sjelljen e të akuzuarit pas veprës penale të kryer, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin e rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PKA.nr.185/2012 me datë 24.09.2014

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.